



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 190, Datë 31/08/2016

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

**K O N S T A T O N :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat "a" dhe "c", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 05, datë 31.01.2014, që shtetasi [emri i shtetasit] ka paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër znj. [emri i drejtores] me detyrë Drejtore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për diskriminim për shkak të bindjes politike.

Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në fund të procedurës së hetimit ka dalë Vendimi nr. 103, datë 07.06.2016. me anë të të cilit është vendosur: "*Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të shtetasit [emri i shtetasit], nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në fushën e punësimit për shkak të bindjes politike*". Në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioneri ka rekomanduar: "*DPT të shikojë mundësinë për kthimin në punë të z. [emri i shtetasit], si masë konkrete për të eliminuar situatën diskriminuese. Palët e interesuara kanë marrë dajeni për vendimin.*"

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe në pikën 3, të Vendimit nr. 103, datë 07.06.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duhet të raportonte, brenda 30 ditëve, para Komisionerit për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke bërë me dije Komisionerin për masat e marra.

Me shkresën Nr. 18865/1, datë 17.06.2016, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, informon se: "*Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", pozicionet e punës, të cilat trajtohen në mbështetje të dispozitave të këtij ligji, administrohen nga Departamenti i Administratës Publike, për këtë arsye,*"

1



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)

*Administrata Tatimore, nuk ka tagër për rekrutimin apo rimarrjen në punë të punonjësve. Gjithashtu, ka sjellë në vëmendje të Komisionerit se vendimi "Lirimit nga detyra" i z. është bërë objekt gjykimi, i cili ka përfunduar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka vendosur rrëzim e kërkesë padisë së z. si dhe çështja është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Pra palet janë ende në një konflikt gjyqësor, të pa zgjidhur me vendim të formës së prerë".*

Duke qenë se çështja e mësipërme gjyqësore nuk ka për objekt konstatimin e diskriminimit, me shkresën nr.737, datë 22.07.2016, Komisioneri ka njoftuar DPT në lidhje me detyrimin për zbatimin brenda afateve ligjore të Vendimit nr. 103, datë 07.06.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim.

Me shkresën Nr. 25521/1, datë 09.08.2016, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve thekson se nuk mund të angazhohet për të zbatuar brenda afateve ligjore Vendimin nr. 103, datë 07.06.2016 të Komisionerit pasi pasojat e pretenduara të ardhura nga diskriminimi janë riparuar, dhe shtetasi është angazhuar në një marrëdhënie të re punësimi, të vazhdueshme dhe të pandërprerë pranë Bashkisë Shkodër.

**Theksojmë se marrëdhënia e re e punësimit e z. nuk ka të bëjë aspak me zbatimin e vendimit nr. 103, datë 07.06.2016 të Komisionerit, por ka të bëjë me përpjekjet personale të z. për tu punësuar.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka informuar DPT se vendimi i tij mund të ankimohet në gjykatë, por kjo nuk është ndjekur si rrugë ligjore.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, është në shkëlqje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", pasi nuk ka zbatuar vendimin Nr. nr. 103, datë 07.06.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTË ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "ç", nenin 33, pikat 11,12,13/b e 14 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **VENDOSI:**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të gjobitet me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi. Paguesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.

3. Zbatimi i vendimit nr. 103, datë 07.06.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
4. Subjekti, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

**Irma BARAKU**

